



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:219164
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05553898

C.nr.2023:219164

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala në çështjen juridike të paditësit: A.G., nga fshati ...-Has Republika e Shqipërisë, të cilin e përfaqëson avokat Fatmir Ademaj nga Peja, ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “...I” në Prishtinë rr. “ .” nr.19- Pejton, me objekt Kompensim demi sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000.00 euro, jashtë seancës me datë 05.04.2024, morri këtë :

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia me numër C.nr.2023:219164 e ushtruar me datën 13.10.2023 e ushtruar nga paditësi A.G., nga Republika e Shqipërisë, ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “...” në Prishtinë, në çështjen juridike Kompensim demi sipas auto-përgjegjësisë,

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë me datën 13.10.2023 ka ushtruar padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “...I” në Prishtinë me objekt kontesti Kompensim demi sipas auto-përgjegjësisë, dhe vlerë të kontestit 1.000.00

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 22.03.2024 i ka kërkuar Gjykatës që ta tërheqë padinë e paditësit për faktin se paditësi ka realizuar interesin juridik në procedure jashtëgjyqësorë, duke lidhur marrëveshje jashtëgjyqësorë, me këtu te paditurën Kompania e Sigurimeve “...” në këtë çështje kontestimore.

Në rastin konkret, gjykata duke aplikuar nenin 261 par.1 të LPK-së ku parashihet se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*, e duke qenë se i padituri nuk ka ushtuar përgjigje në padi, gjykata erdhi në përfundim se duhet vendosur si në pikën I të diapozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimin rreth shpenzimeve procedurale gjykata e mori në mbështetje të nenit 450 dhe 463.1 dhe 4 e LPK-së.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, konform nenit 261 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Përgjithshëm -
C.nr. 2023:219164, datë 05.04.2024

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi në kuptim të nenit 261.4 të LPK-së, nuk lejohet ankesa.